

KLSH merr pjesë në workshop-in me temë “Siguria Kibernetike” mbajtur në Oslo, Norvegji

Në datat 26 Shtator – 1 Tetor, përfaqësues të Kontrollit të Lartë të Shtetit morën pjesë në workshop-in me temë “Siguria Kibernetike”, i cili u zhvillua në ambientet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm në Oslo, Norvegji. Ky workshop, në të cilin ishin pjesëmarrës edhe përfaqësues të vendeve të tjera si Kosova, Maqedonia e Veriut dhe Suedia, konsistoi në trajtimin e çështjeve të sigurisë kibernetike dhe kompjuterike, ku pjesëmarrësit përmes rasteve praktike shkëmbyen eksperiencat duke filluar nga përzgjedhja e kriterëve të auditimit, aplikimi i teknikave të auditimit përmes të cilave një auditues sigurohet që ka marrë evidenca të mjaftueshme, e deri tek hartimi, zhvillimi dhe raportimi i një programi auditimi.



Përgjatë ditëve të workshop-it, u trajtuan temat e riskut dhe materialitetit, analiza e riskut, kriteret e auditimit, vlerësimi i riskut, teknikat e auditimit, si dhe hartimi dhe raportimi i auditimit. Një vëmendje e veçantë iu kushtua teknikave të auditimit, për të cilat u zhvilluan ushtrime praktike në kuadër të shkëmbimit të eksperiencës edhe me vendet e tjera pjesëmarrëse, ku u theksuan teknika si masat e sigurisë kompjuterike, OSINT dhe sistemet ndërfaqëse në internet, autentifikimi, përditësimi dhe patching, logging, backup, si dhe rimarrja e të dhënave.

Shkëmbimi i eksperiencave dhe njohurive edhe me vendet fqinje kontribuoi pozitivisht në të kuptuarit e praktikave më të mira duke marrë në konsideratë rëndësinë e parandalimit të cënimit të sigurisë kibernetike, sidomos me ritmin gjithnjë në rritje të digjitalizimit të proceseve dhe praktikave të punës. Sulmet kibernetike mund të shkaktohen nga dobësi apo mangësi që sjellin ekspozim të sistemeve apo nga ndryshime të paautorizuara në sisteme dhe të dhëna, ku përfshihet edhe rrjedhja e të dhënave apo mangësitë në disponueshërinë e tyre. Në këtë kuadër, për të mbrojtur

të dhënat dhe shërbimet publike nga sulmet kibernetike, audituesit duhet të kuptojnë sesi ndodhin këto sulme dhe si mund të parandalohen ato.

Ky workshop u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit të vijueshëm ndërinstitucional me homologët e Institucionit Suprem të Auditimit të Norvegjisë, të cilët kanë asistuar në rritjen e kapaciteteve teknike në fushën e teknologjisë së informacionit për stafin auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

